REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# KËSHILLI I QARKUT KORÇË

## VENDIM

**Nr. 34, dt. 13.09.2024**

***MBI NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT DHE SHTIMIN E FONDIT PËR INVESTIMIN ME OBJEKT "RIKONSTRUKSIONI I MUZEUT DRITËRO AGOLLI, DEVOLL"***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise",i ndryshuar Ligjit "Për buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, Vendimin e Keshillit te Qarkut nr. 25 date 22.12.2023 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024", Vendimin e Keshillit te Qarkut nr. 14 datë 15.03.2024 "Mbi disa ndryshime në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2024, si dhe bazuar në Kërkesën e ardhur nga Bashkia Devoll, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

## V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimin e emërtimit të investimit me objekt "Rikonstruksioni i Muzeut Dritëro Agolli, Devoll"
   Ishte : Rikonstruksioni i Muzeut Dritëro Agolli, Devoll"
   Bëhet : Ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli

2. Të miratojë ndryshimet në buxhet për të shtuar fondin e investimit me objekt " " si më poshtë:
   Pakësim fondi

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Gr. 00 | Tit 08220 | Kap. 05 | Art. 602 | 4084711 lekë | (Për pjesëmarje në projektet e BE) |
| Gr. 00 | Tit 08220 | Kap. 01 | Art. 602 | 1110880 lekë | |
| Gr. 00 | Tit 10430 | Kap. 01 | Art. 602 | 242810 lekë | |
| Gr. 00 | Tit 04130 | Kap. 01 | Art. 602 | 92604 lekë | |
| Gr. 00 | Tit 01110 | Kap. 01 | Art. 602 | 299476 lekë | (Kuota anëtarësimi SHKQ, AER etj) |
| Gr. 00 | Tit 04520 | Kap. 05 | Art. 231 | 600000 lekë | (Rikonstruksioni i rruges fshati Grunjas-Kakac-Shqitas kod projekti 0150067) |

Shtesë fondi

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Gr. 00 | Tit 04130 | Kap. 05 | Art. 231 | 4084711 lekë | (Ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli |
| Gr. 00 | Tit 04130 | Kap. 01 | Art. 231 | 1745770 lekë | (Ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli |
| Gr. 00 | Tit 04130 | Kap. 01 | Art. 231 | 535000 lekë | (mbikqyrje objekti Ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli) |
| Gr. 00 | Tit 04130 | Kap. 01 | Art. 231 | 65000 lekë | (kolaudim objekti Ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli) |

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti.

**KRYETARI**
**Erjon Nexhipi**

Miratuar me / 14 / Vota
Vota Pro / 14 /
Vota Kundër / 0 /
Vota Abstenim / 0 /
Zbardhur më datë /13/09/2024

**Koncepto: O. Beqiraj**
**Juristi M.Bylykbashi**
**Sek. K. Qarkut B. Muço**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# KËSHILLI I QARKUT KORÇË

## RELACION

***MBI NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT DHE SHTIMIN E FONDIT PËR INVESTIMIN ME OBJEKT "RIKONSTRUKSIONI I MUZEUT DRITËRO AGOLLI, DEVOLL"***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise",i ndryshuar, Ligjit "Për buxhetin e vitit 2024",Udhëzimin nr.9 dt.20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 25 date 22.12.2023 "Mbi miratimin e buxhetit te Këshillit të Qarkut per vitin 2024", Vendimin e Keshillit te Qarkut nr. 14 datë 15.03.2024 "Mbi disa ndryshime në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2024, si dhe bazuar në Kërkesën e ardhur nga Bashkia Devoll sëbashku me preventivin e rishikuar, vlera e punimeve të ndërtimit të Muzeut Dritëro Agolli është 31202959 lekë. Në këto kushte lind nevoja e rialokimit të fondeve si më poshtë dhe rritjes të fondeve të dedikuara për këtë qëllim.

Pakësim fondi

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Gr. 00 | Tit 08220 | Kap. 05 | Art. 602 | 4084711 lekë | (Për pjesëmarje në projektet e BE) |
| Gr. 00 | Tit 08220 | Kap. 01 | Art. 602 | 1110880 lekë | |
| Gr. 00 | Tit 10430 | Kap. 01 | Art. 602 | 242810 lekë | |
| Gr. 00 | Tit 04130 | Kap. 01 | Art. 602 | 92604 lekë | |
| Gr. 00 | Tit 01110 | Kap. 01 | Art. 602 | 299476 lekë | (Kuota anëtarësimi SHKQ, AER etj) |
| Gr. 00 | Tit 04520 | Kap. 05 | Art. 231 | 600000 lekë | (Rikonstruksioni i rruges fshati Grunjas-Kakac-Shqitas kod projekti 0150067) |

Këto fonde që po rialokohen janë teprica të mbetura nga projektet deri më tani të realizuara. Fondet për pjesëmarrje në projektet e BE-së mund të përdoren dukë qënë se aplikimi i projekteve të huaja do të fillojë vitin e ardhshëm

Shtesë fondi

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Gr. 00 | Tit 04130 | Kap. 05 | Art. 231 | 4084711 lekë | (Ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli) |
| Gr. 00 | Tit 04130 | Kap. 01 | Art. 231 | 1745770 lekë | (Ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli) |
| Gr. 00 | Tit 04130 | Kap. 01 | Art. 231 | 535000 lekë | (mbikqyrje objekti Ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli) |
| Gr. 00 | Tit 04130 | Kap. 01 | Art. 231 | 65000 lekë | (kolaudim objekti Ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli) |

Kostoja totale e projektit sipas preventivit të Bashkisë Devoll është 31202959 lekë, nga të cilat 15000000 lekë janë miratuar me Vendimin nr.14 dt.15.03.2024, 8000000 lekë do të financohen nga të ardhurat e realizuara nga kontributet e bashkive , 2372478.72 nga fondet e ardhura nga donatorët e huaj si rimbursim shpenzimesh për shpenzimet e realizuara per projektin save water, dhe 5830481lekë do të sigurohen nga rialokimi i mësipërm i fondeve.
Gjithashtu bazur në preventivin e dorezuar nga Bashkia Devoll, është bërë nga ana e inxhinierit tonë edhe përllogaritja për zërat mbikqyrje dhe kolaudim të cilat kapin vlerën 600000lekë.

Për vetë rëndësinë që ka ky projekt investimi , jo vetëm për Bashkinë Devoll, por për të gjithë Qarkun tonë, i kërkojmë Këshillit miratimin e tij.

Përgjegjëse e Financës
Oljona Beqiraj

Korcë, më 22.08.2024